

 AGENCIA PËR FIGHTIN E KORRUPSIONIT AND CORRUPTION AGENCY		Nr. i akt. 02	Data 24.12.2012
Lloji DPK/DMP	Nr. i akt. 03-4596/12	Re.l.nr.642/2012	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Hebip Osmani nga fshati Kuk komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 11,12.2012, merrë këtë

A K T V E N D I M

I PANDEHURI Hebip Ramadan Osmani i lindur me 19.06.1963 në fshatin Kuk komuna e Dragashit, Shqiptar, Shtetasë i Republikës së Kosovës, Arsimtar, këshilltar i Asambles komunale në Dragash, i martuar prind i 3 femijve, me banim të përherëshëm në vendlindje.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Për arsye se si zyrtar i lartë publik, si këshilltar në Asamblen komunale në Dragash, në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me 31.mars të vitit 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formularin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit nr.04/L-050, e në bazë të kësaj dispozite e konform nenit 9.par. 1. të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe i pandehuri,

DENOHET

ME XHOBË, në shumën prej 50 euro (pesdhëjeteuro).

I pandehuri obligohet që xhobën ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmeris së këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmes kësaj gjykate Në të kundërtën do të bëhet arktimi me dhunë i xhobës, me aktvendim të veçant.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në llogarin bankare përmesë kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë, 01-212153/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Hebip Osmani me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

I pandehuri Hebip Osmani në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësiaht për mes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formularin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Ka deklaruar se

03-4596/12/02
flug

me të u njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me dt. 12.04.2012 e ka paraqit formularin dhe njëherit e ka bër deklarimin e pasurisë. I Pandehuri ka deklaruar se në Asambles komunale në Dragash është nga viti 2007. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes dhe marrëjes së aktvendimit të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejnë si rrethana letësuese.

Gjykata për vërtetimin e sakt të rrethanave të kundërvajtjes me dt.07.12.2012, në seancën e shqyrtimit verbal, ka ndërguar deshmitarin –personin kontaktues Beqir Rashitin i cili sipas proqesverbalit ka deklaruar se me dt.05.03.2012, me shkresën 02,Nr,zr. i kamë njoftuar të gjithë këshilltarët e asambles komunale në Dragash, duke përfshir edhe Hebip Osmani, duge i dërguar edhe formularin e zbratur për deklarimin e pasurisë. Deshmitari ka deklaruar me plot përgjegjësi se këshilltari Hebip Osmani, mua si person kontaktues nuk më ka njoftuar dhe nuk më ka dorzuar formulari deri më dt. 31.03.2012, gjithashtu edhe pas kësaj date.

Gjykata ka lexuar shkresat së lëndës të Agjencionit kundër korrupsionit, deklaratën e të pandehurit, deklaratën e deshmitarit, deshmite e prezentuara dhe pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se i pandehuri Hebip Osmani, si zyrtar publik i obliguar për ta deklaruar pasurinë, në afatin e përcaktuar ligjor si në dispozitiv, nuk e ka plotësuar dhe nuk i ka dërguar formularin e plotësuar Agjencionit më së voni deri më dt.31.03.2012.

Me këto veprime ka kryer kundërvajtje nga neni 6.pik 1 dhe 3. të sanksionuar me nenin 17 pika 1. të Ligjit nr/04/L-050

Gjykata fajësin e të pandehurit e ka mbështet, në deklaratën bindëse të deshmitarit, personit kontaktues, Beqir Rashiti se i pandehuri me shkresë ka qenë me kohë i njoftuar me formularin, njëherit për obligimin ligjor, si dhe me vet faktin se i pandehuri formularin e plotësuar për deklarimin e pasurisë Agjencionit i ja ka dorzuar me vones me dt.12.04.2012.

Gjykata ndaj të pandehurit konform nenit 9 par.1 të LMK-së e ka bër zbutjen e denimit nga rrethanat, se i pandehuri për herë të parë ka kryer kundërvajtje të kësaj natyre, se në gjykatë ka patur sjellje korrekte dhe nga rrethanat se është i gjendjes së dobët ekonomike. Nga rrethanat se i pandehuri është pënduar për kundërvajtjen e kryer pasi që me të kuptuar përgjegjësin me dt.12.04.2012. Agjencionit përmes formularit i ja deklaruar pasurinë.

Me sa u tha me lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË
DRAGASH, Me datën 11.12.2012, Re.I.nr.642/2012.



Gjyqtari për kundërvajtje,
Bekir Vehapi